



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës / Korrektivna Sluzba Kosova / Kosovo Correctional Service

Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 21/06/2024

Duke u bazuar në nenin 12 paragraf 1, nën paragraf 1.10 të ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxjerr:

VENDIM

I. Miratohet Rregulla e Brendshëm për Vlerësimin e Rrezikshmërisë për të Burgosur.

II. Rregulla e Brendshëm për Vlerësimin e Rrezikshmërisë për të Burgosur do të zbatohet nga të gjitha Institucionet Korrektuese, Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë dhe njësitë relevante të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi nga data 24 Qershor 2024.


Ismail Dibrani
Drejtör i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Vendimi ju dërgohet:

1. Institucioneve Korrektuese;
2. Qendrës Operative të SHKK-së;
3. Arkivit të SHKK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

RREGULL E BRENDSHME

PËR

VLERËSIMIN E RREZIKSHMËRISË PËR TË BURGOSURIT

Qershor, 2024

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, nën paragrafi 1.10 të ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm nxjerr:

Rregull të Brendshëm për Vlerësimin e Rrezikshmërisë për të Burgosur

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulle është vlerësimi i të burgosurve në aspektin e sigurisë dhe përcaktimi i kriterëve për kategorizimin e të burgosurve në bazë të nivelit të rrezikshmërisë për të garantuar siguri institucionale dhe individuale.

Neni 2 Shkurtesat

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull të brendshme nënkuptojnë:

- 1.1. KVR - komisioni për vlerësimin e rrezikshmërisë së të burgosurve;
- 1.2. RRL - rrezikshmeri e lartë;
- 1.3. RRSHL - rrezikshmëri shumë e lartë;
- 1.4. RRBL - rrezikshmëri e brendshme e lartë;
- 1.5. RRJL - rrezikshmëri i jashtme e lartë;
- 1.6. RRBShL - rrezikshmëri e brendshme shumë e lartë;
- 1.7. RRJShL - rrezikshmëri e jashtme shumë e lartë;
- 1.8. IK - institucioni korrektues.

Neni 3 Niveli i rrezikshmërisë

1. Të burgosurit që janë në mbajtje në Institucionet Korrektuese duhet t'ju caktohet niveli i rrezikshmërisë në njërin nga nivelet e përcaktuara si më poshtë:

- 1.1. rrezikshmëri e ulët;
- 1.2. rrezikshmëri e mesme;
- 1.3. rrezikshmëri e lartë;
- 1.4. rrezikshmëri shumë e lartë;
- 1.3. rrezikshmëri e brendshme e lartë;
- 1.4. rrezikshmëri e jashtme e lartë;
- 1.5. rrezikshmëri e brendshme shumë e lartë;
- 1.6. rrezikshmëri e jashtme shumë e lartë.

Neni 4 Domethënia e termave

1. Rrezikshmëri e lartë nënkupton kur i burgosuri vlerësohet se ka shenja të kërcënimeve të mundshme brenda dhe jashtë Institucionit Korrektues.

2. Rrezikshmëri shumë e lartë nënkupton kur i burgosuri vlerësohet se ka shenja të kërcënimeve të mundshme brenda dhe jashtë Institucionit Korrektues.

3. Rrezikshmëri e brendshme e lartë dhe shumë e lartë nënkupton kur i burgosuri vlerësohet se ka shenja të kërcënimeve të mundshme brenda Institucionit Korrektues dhe rrezikut të arratisjes nga IK.
4. Rrezikshmëri e jashtme e lartë dhe shumë e lartë nënkupton kur i burgosuri vlerësohet se ka shenja të kërcënimeve të mundshme jashtë Institucionit Korrektues, rrezikut të arratisjes gjatë përcjelljes jashtë Institucionit Korrektues apo lidhja me krimin e Organizuar.

Neni 5 **Vlerësimi i rrezikshmërisë**

1. Nivelit të sigurisë së përgjithshme duhet ti kushtojmë kujdes si gjatë përcjelljes së të burgosurve jashtë Institucionit Korrektues po ashtu edhe gjatë trajtimit të burgosurve brenda Institucionit Korrektues.
2. Vlerësimi i rrezikut duhet të përdoret si mjet për të zvogëluar rrezikun gjatë përcjelljeve jashtë Institucionit Korrektues si dhe për të shmangur incidentet brenda perimetrit në Institucionin Korrektues.
3. Vlerësimi i rrezikshmërisë duhet të bazohet në të gjitha informacionet që i kemi në dispozicion për të burgosurin, dokumentacionin lidhur me dënimet aktuale dhe të mëparshme, informacionet nga policia, prokuroria, gjykata, inteligjenca apo informacione nga stafi që punojnë me të burgosurit.
4. I burgosuri i klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të trajtohet nën masat e sigurisë dhe mbikëqyrje maksimale varësisht nga përcaktimi i nivelit të rrezikshmërisë.
5. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë jashtë Institucionit Korrektues nuk duhet të përjashtohen nga pjesëmarrja në aktivitete brenda Institucionit Korrektues dhe duhet të trajtohen si të burgosurit tjerë që nuk kanë nivel të lartë të rrezikut.

Neni 6 **Procedura e vlerësimit të rrezikshmërisë**

1. Të burgosurit i cili pranohet në Institucion Korrektues duhet t'i bëhet vlerësimi fillestar i sigurisë nga njësia përkatëse e sigurisë në Institucionin Korrektues e cila përcakton nivelin e rrezikshmërisë për secilin të burgosur duke e vendosur në dosjen e të burgosurit.
2. Institucioni Korrektues ku është pranuar i burgosuri është i obliguar që brenda afatit prej shtatë (7) ditëve të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë.
3. Kur vlerësimi i sigurisë rezulton të jetë i ulët apo i mesëm i burgosuri duhet të trajtohet sipas këtij niveli deri në rivlerësim varësisht nga sjellja e të burgosurit në Institucionin Korrektues.
4. Kur vlerësimi i rrezikshmërisë rezulton të jetë i lartë apo shumë i lartë Drejtori i Institucionit Korrektues e njofton kryesuesin e Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë lidhur me vlerësimin

dhe përcaktimin e nivelit të rrezikut fillestar dhe propozon që i njëjti të shqyrtohet nga Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë.

5. Në çdo rast kur udhëheqësi për siguri në Institucionin Korrektues vlerëson se kanë ndryshuar rrethanat dhe faktorët e rrezikut që tregojnë se është ulur apo rritur niveli i rrezikut së të burgosurit kërkon nga Drejtori i Institucionit Korrektues që rastin ta procedojë në Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë.

Neni 7

Emërimi i Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë

1. Drejtori i Përgjithshëm i SHKK me qëllim të shqyrtimit të propozimeve për vlerësimin e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë emëron Komisionin për Vlerësimin e Rrezikshmërisë në përbërje si në vijim:

- 1.1. Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Siguri dhe Operativë në SHKK;
- 1.2. Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Trajtim të Burgosurve në SHKK;
- 1.3. Drejtori i Departamentit për Siguri dhe Operativë në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKK-së;
- 1.4. Drejtori i Institucionit Korrektues përkatës;
- 1.5. Përfaqësues nga Policia e Kosovës.

Neni 8

Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë

1. Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë pas pranimi të propozimeve nga Drejtori i Institucionit Korrektues përkatës për kategorizimin e të burgosurve thërret mbledhjen për të shqyrtuar dhe vendosur nivelin e rrezikshmërisë.

2. Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë mbledhet jo më larg se 30 ditë pas pranimi të propozimeve, ndërsa për rastet e rivlerësimeve të nivelit të vendosur të rrezikshmërisë jo më larg se gjashtë (6) muaj.

5. Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë gjatë një vlerësimi mund të heq të burgosurit vetëm një (1) shkallë e rrezikshmërisë.

Neni 9

Procedura

1. Kryesuesi i Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë para mbledhjes së komisionit kërkon raportin me shkrim për secilin të burgosur që do të shqyrtohet nga përfaqësuesi i Institucionit Korrektues përkatës.

2. Raporti me shkrim duhet të dërgohet te kryesuesi i Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë se paku pesë (5) ditë pune para datës të mbledhjes.

3. Kryesuesi i Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë formon listën e rasteve që do të shqyrtohen ku janë të evidentuara informatat e nevojshme cilën e dërgon tek anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë së paku dy (2) ditë pune para mbledhjes.

4. Kryesuesi i Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë kërkon nga Drejtori i Institucionit Korrektues përkatës të prezantojë raportin e sigurisë duke arsyetuar propozimin për vendosjen e rrezikshmërisë para anëtarëve të komisionit.

Neni 10

Kriteret për caktimin e nivelit të rrezikshmërisë

1. Vendimi për caktimin e nivelit të rrezikshmërisë duhet të merret duke u bazuar në rreziqet individuale dhe vlerësimin e sigurisë.

2. Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë merr për bazë kriteret e përcaktuara si në vijim por pa u kufizuar vetëm në:

- 2.1. rreziku për dhunë dhe për kërcënim ndaj stafit dhe të burgosurve të tjerë;
- 2.2. rreziku nga abuzimi me drogë apo alkool;
- 2.3. rreziku për ikje apo rreziku për largim nga institucioni me ndihmë nga jashtë;
- 2.4. rreziku që mund ti kanoset të burgosurit gjatë përcjelljes jashtë Institucionit Korrektues;
- 2.4. informata të tjera të ndërlidhura me rreziqet të cilat mund të jenë relevante.

3. Kriteret tjera të cilat merren parasysh janë:

- 3.1. vlerësimi i sjelljes së të burgosurit brenda institucionit;
- 3.2. vlerësimi për përcjellje jashtë institucionit;
- 3.3. vlerësimet e rasteve të cilat janë në procedurë të ekstradimit;
- 3.4. raportet dhe informatat e institucioneve tjera të sigurisë apo institucioneve publike të cilat paraqesin nivelin e rrezikut për të burgosurin;
- 3.5. urdhëresat e gjykatës apo prokurorisë.

Neni 11

Vendim marrja e Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë

1. Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë shqyrton rastet e paraqitura dhe vendos përfundimisht nivelin e rrezikshmërisë së të burgosurve duke e kategorizuar të burgosurin në njërin nga nivelet e rrezikshmërisë të përcaktuara në nenin dy (2) të kësaj rregulle.

2. Vendimi për caktimin e nivelit të rrezikshmërisë merret me shumicë votash të anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë.

3. Kryesuesi i Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë në raste të caktuara kur ka elemente të bazuara mund të konfirmoj nivelin e rrezikshmërisë për të burgosurin deri në mbledhjen e komisionit dhe obligon Drejtorin e Institucionit Korrektues përkatës që i burgosuri të trajtohet sipas rrezikshmërisë së caktuar.

4. Vendimi për caktimin e nivelit të rrezikshmërisë i dërgohet:

- 4.1. të burgosurit;
- 4.2. Drejtorit dhe Divizionit të Sigurimit në Institucionin Korrektues përkatës;
- 4.3. një kopje vendoset në dosjen e të burgosurit.

5. Kundër vendimit të Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë lejohet ankesa në afat brenda shtatë (7) ditësh nga dita e pranimi të vendimit nga i burgosuri. Ankesa i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së i cili duhet të vendos brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

6. Kryesuesi i Komisionit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë për punën e komisionit e njofton Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK-së për të gjitha rastet e trajtuara.

7. Komisioni mbanë evidencë për kategorizimin e të burgosurve.

Neni 12

Regjistri i të burgosurve me rrezikshmëri

Departamenti për Siguri dhe Operativë në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKK-së mban regjistër me të dhënat e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë si brenda ashtu edhe jashtë institucionit. Lista e të burgosurve duhet të përditësohet varësisht nga ndryshimi i nivelit të rrezikshmërisë.

Neni 13

Formulari për vlerësimin e rrezikshmërisë

Për çdo të burgosur i cili do të shqyrtohet nga Komisioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë duhet që paraprakisht të plotësohet formulari unik përkatës i paraparë në Manualin për përdorimin e Formave Zyrtare në SHKK (forma për vlerësimin e rrezikshmërisë nr. 4.1.8).

Neni 14

Vendosja e të burgosurve të vlerësuar me rrezikshmëri në Institucion Korrektues

Të burgosurit e vlerësuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë vendosen në Burgun e Sigurisë së Lartë, përjashtimisht të burgosurve ndaj të cilëve është caktuar rrezikshmëria për ndonjë arsyeje specifike mund të vendosen në Institucione Korrektuese tjera të tipit të mbyllur. Të burgosurat femra dhe të miturit e vlerësuar me rrezikshmëri vendosen në objekte të veçanta në Institucionin Korrektues përkatës.

Neni 15
Lirimi i të burgosurve të vlerësuar me rrezikshmëri

1. Institucioni Korrektues përkatës me rastin e lirit të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të njoftojë Qendrën Operative të SHKK-së.
2. Qendra Operative e SHKK-së pas marrjes së informacionit për lirin e të burgosurit me rrezikshmëri të lart dhe shumë të lartë e njofton Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK-se dhe Policinë e Kosovës.

Neni 16
Dispozitat shfuqizuese

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulle shfuqizohet Rregulla e Brendshme për Kategorizimin e të Burgosurve sipas Rrezikshmërisë nr. 1170, datë: 15.10.2021.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo rregull e brendshme hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

21.06.2024

Ismail Dibrani

Drejtör i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

